



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 2.6.2023

Nr: 651

Ora: 09:30

VENDIM  
PËR

**SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË  
PUKË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "i", e 2, nenit 162 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VËREN:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "i", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor me vendimin nr. 260, datë 16.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Këshillin e Bashkisë Pukë. Kundër vendimit të sipërcituar të KZAZ -së është administruar kërkesa ankimore nr. 63, datë 22.5.2023 dhe kërkesa ankimore nr. 70, datë 22.5.2023, me ankues, subjektet zgjedhore "Aleanca Demokristiane e Shqipërisë" dhe "Aleanca Progresiste LZHK", me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 260, datë 16.5.2023, të KZAZ nr. 07, për Këshillin Bashkiak Pukë, si dhe ndryshimin e tabelës përmbledhëse të këshillit bashkiak, sipas rinumërimit dhe rivlerësimit të votave.

Më datë 24.5.2023, në seancë publike Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve shqyrtoi kërkesat ankimore, në përfundim të së cilës vendosi:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesave ankimore nr. 63 dhe nr. 70, datë 22.5.2023.
2. Korrigjimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për KZAZ nr. 07, Bashkia Pukë, sipas gjetjeve të konstatuara nga KAS, sipas tabelës bashkëlidhur.

Në bazë të nenit 162, pika 1, dhe nenit 166, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përllëgarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Data: 2.6.2023 Nr: 651  
Ora: 09:30



"Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Pukë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

Rezultati për subjektet zgjedhore, për Këshillin e Bashkisë Pukë pasqyrohet në tabelën nr. 1 në vijim:

(Tabela nr. 1)

Nr. FV	Subjekti Zgjedhor	Vota	Përqindja
1	Bashkë Fitojmë	482	8,31 %
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	682	11,76 %
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	25	0,43 %
4	Partia Republikane Shqiptare	170	2,93 %
5	Partia Lëvizja e Legalitetit	72	1,24 %
6	Partia Demokracia Sociale	287	4,95 %
7	Aleanca Liberale e Djathtë	132	2,28 %
8	Partia Socialdemokrate	1022	17,63 %
9	Partia Demokratike	281	4,85 %
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	247	4,26 %
11	Fryma e Re Demokratike	380	6,55 %
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	164	2,83 %
14	Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë	348	6,00 %
17	Aleanca Arbnore Kombëtare	576	9,93 %
18	Partia Balli Kombëtar	258	4,45 %
21	Fronti i Majtë	270	4,66 %
34	Partia Kristian Demokrate	160	2,76 %
38	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	242	4,17 %
	<b>Totali</b>	<b>5798</b>	<b>100 %</b>

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 15 (pesëmbëdhjetë) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Bashkia Pukë, në bazë të shkresës me shkresën me nr. 187/1 Prot, datë 27.2.2023, të Prefektit të Qarkut Shkodër.

Herësit e përfitur nga ky pjesëtim pasqyrohen në tabelën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përfitur nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse, pra 15 (pesëmbëdhjetë). Nga kjo renditje marrim rezultatin e pasqyruar në tabelën nr. 3, në vijim:

(Tabela nr. 3)

Nr.	Herësi	Subjekti
1	1022	Partia Socialdemokrate

2	682	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	576	Aleanca Arbnore Kombëtare
4	511	Partia Socialdemokrate
5	482	Bashkë Fitojmë
6	380	Fryma e Re Demokratike
7	348	Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë
8	341	Partia Socialiste e Shqipërisë
9	340	Partia Socialdemokrate
10	288	Aleanca Arbnore Kombëtare
11	287	Partia Demokracia Sociale
12	281	Partia Demokratike
13	270	Fronti i Majtë
14	258	Partia Balli Kombëtar
15	255	Partia Socialdemokrate

Në bazë të nenit 162, pika 5, të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar në tabelën nr. 3.

Nga kryerja e veprimeve të mësipërme marrim rezultatin për shpërndarjen e mandateve të pasqyruar në tabelën nr. 4, në vijim:

(Tabela nr. 4)

Nr.	Subjekti Zgjedhor	Mandate
1	Bashkë Fitojmë	1
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	2
3	Partia Demokracia Sociale	1
4	Partia Socialdemokrate	4
5	Partia Demokratike	1
6	Fryma e Re Demokratike	1
7	Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë	1
8	Aleanca Arbnore Kombëtare	2
9	Partia Balli Kombëtar	1
10	Fronti i Majtë	1

Sipas nenit 163, pika 1 dhe të nenit 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "I", e 2, nenet 162 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

## VENDOS:

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Pukë, si më poshtë:

<b>Subjekti Zgjedhor</b>	<b>Mandate</b>
Bashkë Fitojmë	1
Partia Socialiste e Shqipërisë	2
Partia Demokracia Sociale	1
Partia Socialdemokrate	4
Partia Demokratike	1
Fryma e Re Demokratike	1
Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë	1
Aleanca Arbnore Kombëtare	2
Partia Balli Kombëtar	1
Fronti i Majtë	1

2. Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Pukë, si më poshtë:

### **Bashkë Fitojmë**

1. Demir Muhamet Syla

### **Partia Socialiste e Shqipërisë**

1. Edmond Zef Luka  
2. Besmira Prel Aliaj

### **Partia Demokracia Sociale**

1. Arben Prendush Gugaj

### **Partia Socialdemokrate**

1. Alfons Tonin Gjergjaj  
2. Drita Mark Gjoka  
3. Eduard Frrok Gjoka  
4. Klodisa Ded Qeleshi

### **Partia Demokratike**

1. Gjon Nikoll Gjoka

### **Fryma e Re Demokratike**

1. Besar Hydajet Kuçi

### **Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë**

1. Lindita Hazir Hyseni

### **Aleanca Arbnore Kombëtare**

1. Dritan Zef Asani  
2. Vitore Pal Frroku

### **Partia Balli Kombëtar**

1. Ndue Prenge Lalaj

### **Fronti i Majtë**

1. Enver Osman Sulejmani

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

**Bashkia Pukë, herësit**

**Tabela nr. 2**

NR_FV	SUBJEKTI	SIGLA	1	2	3	4	5	6	7	
1	Bashkë Fitojmë	BF	482	241	160	120	96	80	68	H e r ë s i t
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	682	341	227	170	136	113	97	
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	P.A.A	25	12	8	6	5	4	3	
4	Partia Republikane Shqiptare	PR	170	85	56	42	34	28	24	
5	Partia Levizja e Legalitetit	PLL	72	36	24	18	14	12	10	
6	Partia Demokracia Sociale	P.D.S	287	143	95	71	57	47	41	
7	Aleanca Liberale e Djathtë	ALD	132	66	44	33	26	22	18	
8	Partia Socialdemokrate	PSD	1022	511	340	255	204	170	146	
9	Partia Demokratike	PDSH	281	140	93	70	56	46	40	
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	LZHK	247	123	82	61	49	41	35	
11	Fryma e Re Demokratike	FRD	380	190	126	95	76	63	54	
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	P.D.I.U	164	82	54	41	32	27	23	
14	Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë	AD	348	174	116	87	69	58	49	
17	Aleanca Arbnore Kombëtare	AAK	576	288	192	144	115	96	82	
18	Partia Balli Kombëtar	P.B.K	258	129	86	64	51	43	36	
21	Fronti i Majtë	FM	270	135	90	67	54	45	38	
34	Partia Kristian Demokrate	PKDSH	160	80	53	40	32	26	22	
38	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	ADK	242	121	80	60	48	40	34	